

FORMULARI NUMËR 3

KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Emri:	ISMET
Mbiemri:	RRAHMANI

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni si vijon:

I. Analizën tuaj:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Institucioni i Prokurorit të Shtetit në vazhdimësi ka shënuar progress dhe zhvillim adekuat në drejtim të kompetencave të veta ligjore dhe kushtetuese, duke treguar profesionalizëm në kryerjen e detyrave në mënyre efikase dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur profesionalizmin dhe pavarësinë e tij.

Institucioni i Prokurorit të Shtetit ka krijuar bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera të drejtësisë dhe ato ndërkombëtare për hetimin dhe ndjekjen e krimeve të organizuara, korrupsionit dhe të tjera, siç janë policia, gjykatat dhe agjencitë ndërkombëtare si Europol etj.

Gjatë viteve të fundit, Institucioni i Prokurorit të Shtetit ka shënuar progres në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe në vazhdimësi është punuar në nxjerrjen e Rregulloreve, Udhëzimeve në fushat e ndryshme në kuadër të kompetencave ligjore me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë dhe ngritjes së efikasitetit duke siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë për Prokurorët në punët e tyre, andaj kjo ka ndikuar pozitivisht edhe në luftë ndaj krimit dhe dukurive të tjera negative në shoqëri.

Institucioni i Prokurorit të Shtetit ka arritur progres në fusha të ndryshme duke pas parasysh faktin se në vazhdimësi është punuar për rritjen e numrit të Prokurorëve dhe tani një pjesë e madhe e Prokurorive në Republikën e Kosovës kanë numër të mjaftueshëm të Prokurorëve, stafit mbështetës administrative ku ka rezultuar në zvogëlim të numrit të lëndëve penale që ndërlihet direkt me luftën kundër krimit dhe zhvillimit sa më efikas dhe zbulimit të shpejt, hetimit dhe procedimit të çështjeve penale në përgjithësi, andaj konsideroj se gjendja aktuale në Prokurorinë e Shtetit është më e mirë, ka llogaridhënie dhe disiplinim më të avancuar, mbikqyrje dhe monitorim nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Gjithashtu, konsideroj se në lidhje me fushat strategjike në të cilat synohet të arrihet përmbushja e mandatit kushtetues dhe ligjor dhe efikasitetin e ndjekjes penale, është duke u punuar me intensitet të lartë në profilizimin e prokurorëve, e poashtu ka avansime në funksionalizimin dhe aplikimin e teknologjisë të menaxhimit të lëndëve - SMIL, ku edhe kjo ka ndikuar në kryerjen e punëve në mënyrë më të shpejtë në futjen e të dhënave dhe mbajtjen e tyre më të sigurt në formë elektronike, ku tek kjo e fundit Prokuroria e Shtetit është angazhuar në trajnimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të prokurorëve, përfshirë trajnime për përdorimin e teknologjive të reja dhe për forcimin e kapaciteteve profesionale për trajtimin e çështjeve komplekse.

Gjendja aktuale e Prokurorisë së Shtetit në Republikën e Kosovës ka bërë përparime të dukshme në shumë fusha, veçanërisht në përmirësimin e profesionalizmit, përdorimin e teknologjisë, dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare dhe kombëtare. Megjithatë, sfidat ende mbeten në fushat e pavarësisë institucionale, efikasitetit të procesit penal, dhe kapaciteteve të nevojshme për të trajtuar krimet e rënda dhe të komplikuar si krimi i organizuar dhe korrupsioni. Në përgjithësi, ka hapësirë për përmirësime të mëtejshme dhe rritje të performancës institucionale.

2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?

Gjendja në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, aktualisht konsideroj se është e mirë, duke pas parasysh faktin se gjendja aktuale me numër të Prokurorëve dhe staf mbështetës ka shënuar rritje, ku si rezultat i kësaj është duke u arritur sukses në përfaqësimin e gjykimeve në Gjykatën Themelore në Ferizaj, dhe degët e saj në Kaçanik dhe Shtërpc.

Poashtu, lidhur me ngarkesën me lëndë si dhe zgjidhjen e këtyre lëndëve, konsideroj se gjendja është mjaft e mirë duke pas parasysh se përmes angazhimit shtesë nga ana e Prokurorëve është arritur që të mos ketë mbingarkesë me lëndë dhe kjo ka ndikuar në kryerjen e lëndëve në afate të arsyeshme dhe në ngritjen e cilësisë të punës së Prokurorit në përgjithësi.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Prokurori i Shtetit si institucion i pavarur për hetimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të personave të akuzuar për vepra penale përballet me sfida të ndryshme dhe mangësi të ndryshme e me të cilat në vazhdimësi është bërë përpjekje për eliminimin dhe kalimin e pengesave, rrespektivisht në P.TH Ferizaj janë identifikuar sfidat kryesore të punës së saj gjatë të kaluarës dhe tani sidomos me numrin e madh të lëndëve të Kallëzimeve Penale me persona të panjohur, të cilat lëndë janë trashëguar

nga viti në vitin pasues edhe përkundër kërkesës nga ana e Prokurorisë për identifikimin e kryesve të këtyre veprave dhe si të tilla ende mbeten lëndë të pakryera. Si sfidë, ende mbeten pengesat e natyrave të ndryshme sidomos ndërlidhja e sistemit elektronik për menaxhimin e lëndëve me Polici, por që gradualisht kohëve të fundit këto problematika kanë filluar të evitohen andaj në të ardhmen do të angazhohemi që këto sfida të evitohen.

Sa i përket mangësive, konsideroj se në P.TH Ferizaj duhet të angazhohemi në avancimin dhe ngritjen e hetimit financiar, krimeve ekonomike dhe korrupsionit. Poashtu, edhe në ngritjen e cilësisë së akteve akuzuese, aplikimin më të madh të procedurave alternative si dhe aplikimin e institutit të pranimit të fajësisë.

4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Konsideroj se strategjitë aktuale të adresuara nga ana e sistemit prokurorial në përgjithësi përmbushin nevojat e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, duke pas parasysh se sistemi prokurorial gjithmonë ka pasur dhe ka plane strategjike përmes të cilave adresohen të gjitha nevojat edhe të prokurorisë për të cilën kam aplikur për kryeprokuror, e që mbështeten në shtyllat e përcaktuara si: profesionalizmi dhe pavarësia në sistemin prokurorial, efikasitetit dhe efektiviteti në ndjekjen e krimit, profilizimi i prokurorëve dhe trajtimi i rasteve me prioritet, menaxhimi dhe administrimi, integriteti, llogaridhënia dhe etika, si dhe transparenca në sistemin prokurorial, të cilat konsideroj që ndërlidhen edhe me prokurorinë ku kam aplikuar, aq më tepër me objektivat që dalin nga këto shtylla dhe strategjitë e tjera të aplikuar në lidhje me caktimin e koordinatorëve në ZKPSH dhe caktimin e koordinatorëve në kuadër të Prokurorisë Themelore në lidhje me dhunën në familje, veprat penale kundër intergjititit seksual, trafikimit me njerëz, për çështjet penale me ndihmë juridike ndërkombëtare, etj,

Duke i pas parasysh të gjitha të lartëcekurat, konsideroj se zbatim i strategjive aktuale të sistemit adresojnë edhe nevojat e Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?

Në pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, vizioni im si Kryeprokuror do të jetë puna e vazhdueshme për arritjen e standarteve dhe vlerave më të larta të profesionalizmit, ndershmërisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës në drejtim të bashkëpunimit sa më të ngushtë me Prokurorët e P.TH Ferizaj dhe atë përmes marrjes së vendimeve që sigurojnë pavarësinë, paanshmërinë dhe efikasitetin e institucionit, poashtu bashkëpunim sa më të ngushtë edhe me Bashkëpunëtorët Profesional të cilët kanë një rol mjaft të rëndësishëm në mbështetjen profesionale për Prokuror, ashtuqë do të angazhohen sidomos në rritjen e nivelit profesional në çështje të hetimit, aktakuzave, vendimeve që ka në kompetencë Prokurori i Shtetit.

Poashtu, do të punoj nga afër me Prokurorët kompetent në trajtimin e veprave karakteristike posaqërisht veprat e natyrës korruptive, krimeve ekonomike, trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit me lëndë narkotike etj.

Përmirësimi i punës operative nuk është i mundur pa një koordinim të fortë dhe bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve të ndryshme të drejtësisë, përfshirë Policinë e Kosovës, Gjykatat, Agjencitë e mbikëqyrjes dhe Institucionet ndërkombëtare. Unë kam për qëllim të forcoj këtë bashkëpunim duke krijuar protokolle të qarta komunikimi dhe koordinimi, duke përfshirë përdorimin e platformave të përbashkëta për ndarjen e informacionit dhe mbështetje në hetimet dhe ndjekjen e rasteve.

Vizioni im do të orientohet në angazhimin tim maksimal, në koordinim me KPK dhe ZKPSH, për punë të pavarur dhe të paanshme për prokuror, që të njejtit po ashtu të kryejnë një punë sa më profesionale në drejtim të hetimit, zbulimit dhe trajtimit të rasteve në hetime dhe përfaqësimin në gjykatë dhe me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të punës operative.

Po ashtu vizioni im në pozitën e Kryeprokurorit me qëllim të përmirësimit të punës operative do të fokusohet por nuk do të kufizohet në:

- Hartimi i planit të punës, respektivisht planifikimin në lidhje me zvogëlimin e lëndëve.
- Mbajtjen e takimeve të rregullta të kolegjiutit me prokuror, takimeve ditore për konsultime për çështje individuale, takime me stafin mbështetës të prokurorisë.
- Rritjen e nivelit të bashkëpunimit me institucionet tjera relevante që ndërlidhet me punën e prokurorisë, gjykata, policia, agjencionet e ndryshme
- Hetimi dhe ndjekja penale në mënyrë të drejtë dhe efektive duke respektuar të drejtat e palëve në procedurë.
- Rritjen e nivelit të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së përfituar me veprë penale apo që kanë shërbyer në kryerjen e veprës penale, etj.
- Do të mbaj takime me qytetar në ditë të caktuar po edhe ditëve të tjera.

2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Institucioni i Prokurorit të Shtetit, përmes strategjive të ndryshme në fusha të caktuar, synon të arrij objektivat kushtetuese dhe ligjore në përmbushjen e obligimeve, ashtu që objektivat e mia në pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë që do të aplikoj, do fokusohen në drejtim të arritjes së objektivave strategjike të sistemit prokurorial në përmbushjen e obligimeve të mia në bazë të dispozitave ligjore, duke respektuar dhe garantuar të drejtat e qytarëve, duke siguruar që prokurorët të veprojnë konform dispozitave ligjore, ashtu që objektivat e mia do të fokusohen por nuk do të kufizohen si në vijim:

Përmirësimi i Pavarësisë dhe Efikasitetit të Prokurorisë

Objektivi: Rritja e pavarësisë institucionale të Prokurorisë së Shtetit dhe reduktimi i ndikimeve të jashtme në proceset hetimore dhe gjyqësore.

- Veprimet:
 - Forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e pavarësisë profesionale të prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë.
 - Rritja e transparencës në proceset vendimmarrëse dhe raportimi i aktivitetit të Prokurorisë në mënyrë periodike.
 - Krijimi i një kulture që inkurajon autonominë e prokurorëve dhe zbatimin e ligjit pa ndikime të jashtme.

Rritja e Efikasitetit të Hetimeve dhe Procedurave Penale

Objektivi: Optimizimi i procedurave hetimore dhe përshpejtimi i procesit penal, duke garantuar rezultate efikase dhe në kohë të duhur.

- Veprimet:
 - Rritjen e nivelit të ndjekjes së veprave penale në përgjithësi duke veçuar veprat penale karakteristike që ndërlidhen edhe me strategjitë e Sistemit Prokurorial.

Lufta kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit

Objektivi: Forcimi i kapaciteteve për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke ndihmuar në trajtimin e rasteve të rëndësishme dhe të ndjeshme.

- Veprimet:
 - Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për ndjekjen dhe identifikimin e grupeve kriminale dhe korrupsionit në nivelet më të larta të pushtetit.
 - Angazhimi i trajnimeve të vazhdueshme për prokurorët dhe hetuesit për metodat e avancuara të hetimit dhe ndjekjes penale në rastet komplekse.

Rritja e Integritetit dhe Transparencës Institucionale

Objektivi: Përmirësimi i integritetit të Prokurorisë së Shtetit dhe rritja e transparencës për të forcuar besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

- Veprimet:
 - Publikimi i raporteve të performancës dhe statistikave për rastet e trajtuara, duke siguruar një sistem të hapur dhe transparent.
 - Ofrimi i mundësive për trajnime dhe zhvillimin e vazhdueshëm të prokurorëve dhe stafit për të parandaluar praktikën e këqija dhe për të forcuar etikën profesionale.

Përmirësimi i Bashkëpunimit Ndërinstitucional dhe Ndërkombëtar

Objektivi: Rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera të drejtësisë, agjencitë e sigurisë dhe partnerët ndërkombëtarë për të rritur efektivitetin e hetimeve dhe ndjekjes penale.

- Veprimet:
 - Forcimi i lidhjeve me organizatat ndërkombëtare si Europol dhe të tjera, për të mbështetur hetimet ndërkufitare dhe për shkëmbimin e informacionit.
 - Krijimi i mekanizmave të koordinuar për hetimet dhe ndjekjen e çështjeve të përbashkëta me agjencitë e tjera, si Policia e Kosovës, Doganën, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Gjykatat.
 - Angazhimi në programe dhe projekte ndërkombëtare që mund të ofrojnë asistencë dhe mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve dhe njohurive të stafit të Prokurorisë.

Përmirësimi i Marrëdhënieve me Publikun dhe Mediat

Objektivi: Rritja e komunikimit dhe bashkëpunimit me publikun dhe mediat për të siguruar që informacionet e nevojshme të jenë të qarta dhe të disponueshme.

- Veprimet:
 - Krijimi i një strategjie për komunikimin me median dhe publikun, duke siguruar informim të duhur mbi zhvillimet dhe rezultatet e hetimeve të rëndësishme.
 - Forcimi i një politike të hapur dhe transparente që garanton se informacionet janë të sakta dhe të mirëmenduara, pa kompromentuar integritetin e hetimeve.
 - Përdorimi i mediave sociale dhe kanaleve të tjera për të komunikuar me qytetarët dhe për t'i mbajtur ata të informuar mbi punën e Prokurorisë.

3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektivave?

Konsiderojmë se vështirësitë që do të mund të paraqiten gjatë përmbushjes së objektivave janë numri i madh i lëndëve me kryes të panjohur, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjen penale ku edhe në të kaluarën janë paraqitur vështirësi për shkak të rasteve komplekse në mungesë të raporteve bilaterale me disa shtete, zbatimi i projektit SMIL.

4. Si do t'i tejkaloni ato?

Sa i përket lëndëve me kryerës të panjohur (PPP), përveç Prokurorëve do të angazhohen edhe Bashkëpunëtorët Profesional, pasi që Prokuroria Themelore e Ferizajt aktualisht ka një numër bukur të madh të lëndëve me kryerës të panjohur, e të cilat janë trashëguar nga vitet paraprake e tutje, edhe përkundër faktit se është arritur kryerja e një numri të madh të lëndëve që i përkasin regjistrin PPP. Sa i përket lëndëve për bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë në çështje Penale, si mënyrë frytdhënëse do të ishte bashkëpunimi me ILEK-un, si dhe përmes trajnimeve me karakter ndërkombëtarë. Po ashtu edhe vështirësitë e paraqitura me projektin SMIL, do të tejkalohen përmes trajnimeve të rregullta me ekspertët e kësaj fushe.

III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?

Një element i rëndësishëm i menaxhimit të stafit është krijimi dhe ruajtja e një kulture të fortë profesionale dhe etike. Si Kryeprokuror, për mua do të jetë thelbësore që të sigurohem që stafi të ndjekë parimet e drejtësisë, integritetit dhe profesionalizmit.

Disa nga pikat kryesore që do të fokusohem janë:

Përcaktimi i vlerave të përbashkëta si transparenca, llogaridhënia, respekti dhe përkushtimi ndaj drejtësisë.

Fuqizimi i moralit të stafit përmes promovimit të frymës së bashkëpunimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Takime të rregullta me stafin për të diskutuar sfidat, përparësitë dhe mundësitë për përmirësim.

Për të arritur nivele të larta të performancës dhe për të mbajtur një staf të kualifikuar dhe të përgatitur, zhvillimi i vazhdueshëm i aftësive profesionale është thelbësor.

2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?

Duke pas parasysh faktin se ndarja e punës duhet bërë në mënyrë të drejtë, duke mos krijuar asnjë paknaqësi tek stafi administrativ në ndarjen e detyrave të përditshme, andaj edhe në të ardhmen do të përpiqem që të bëjë ndarjen e detyrave në mënyrë të drejtë dhe proporcionale konform përshkrimit të detyrave sipas rregullave në fuqi, poashtu do të bëjë përpjekje që të ketë sa më shumë bashkëpunim të ndërsjellë me qëllim të realizimit të detyrave, në veçanti fokus të veçantë do të paraqes në shkrimoren e Prokurorisë në lidhje me futjen e të dhënave në SMIL dhe ndarjen e lëndëve në mënyrë automatike.

3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

Gjithashtu në lidhje me llogaridhënien dhe profesionalizmin, do të kem një kujdes të shtuar në respektimin e personalitetit dhe të drejtave të tyre, gjithashtu në lidhje me punën dhe detyrat që duhet të kryhen nga stafi administrativ, duke mbajtur takime

individuale por edhe kolegjiume në lidhje me çështje të ndryshme, për rritjen dhe përmirësimin e profesionalizmit dhe llogaridhënies në punë, po ashtu në rastet eventuale të lëshimeve nga ana e tyre në lidhje me punën dhe detyrat që i kanë të caktuara, do të kërkoj llogaridhënie dhe përgjegjesi në kuptim të dispozitave ligjore adekuate.

IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?

Duke pasur parasysh faktin se ngritja e nivelit të besueshmërisë në Prokurori është shumë e nevojshme, me përmirësimin e llogaridhënies, transparencës, integritetit dhe profesionalizmit do të ngritët niveli i besueshmërisë së publikut. Gjatë informimit të publikut do të jemi të kujdesshëm që të mbajmë një balancë në procedurën penale, gjithashtu opinionin publik do të njoftohet për raste të caktuara duke ruajtur gjithnjë dhe duke mos e cenuar asnjëherë konfidencialitetin e hetimeve.

2. Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Në të ardhmen fokusi jonë kryesor do të jetë në ngritjen e mëtejme të cilësisë së punës, duke marrë parasysh faktin që tani nuk kemi ngarkesë të madhe me lëndë të rregullta, do të ndërmarrim hapa konkret në ngritjen e cilësisë, çdo hujdhje e akuzës dhe pushim i hetimeve do të kontrollohen së bashku me prokurorin e çështjes, do të i kontrollojmë gjitha akuzat që bëjnë pjesë në veprat penale karakteristike si (veprat e natyrës korruptive, krimeve ekonomike, trafikim me narkotik, trafikimin me qenie njerëzore, dhuna në familje et). Fokus tjetër i imi do të jetë, raportimi i rregullt i prokurorëve lidhur me hetimin e veprave penale si dhe përfundimin e rasteve, e veçanti raportim të veçantë për rastet e ndjeshme të cilat kërkojnë urgjencë për shkak të natyrës së tyre. Ngritjen e cilësisë planifikojmë ta bëjmë edhe përmes kolegjiumeve të rregullta duke i diskutuar çështje të ndryshme profesionale së bashku me të gjithë prokurorët. Vlerësojmë se në ngritjen e punës cilësore do të ndikoj edhe angazhimi i prokurorëve koordinator në fushat e tyre.

3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?


Në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, në kuptim të dispozitave ligjore planifikoi të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për rritjen e nivelit të llogaridhënies nga prokurorët dhe nga stafi mbështetës, ashtu që ndër tjera do të kërkoj që:

- Prokurorët të zbatojnë drejtë dhe në mënyrë profesionale dispozitat ligjore të ligjeve procedurale dhe materiale.
- Të aplikohen në mënyrën e duhur rregulloret dhe udhëzimet e sistemit prokurorial. Raportime të rregullta për punën e tyre, raportimet për çështjet që kanë në punë dhe në fazën e hetimeve.
- Rrespektimi i kodit të etikes dhe sjelljes profesionale duke mbrojtur institucionin e prokurorit të shtetit.
- Punën e tyre të kryejnë duke rrespektuar liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të drejtat që iu takojnë gjatë zhvillimit të procedurës penale pas asnjë dallim.
- Prokurorët të bëjnë përpjekje maksimale në zvogëlimin e lëndëve.
- Të jenë të përgjegjshëm dhe të shprehin integritet të lartë gjatë punës së tyre.
- Çdo prokuror të arrij nivelin e duhur të bashkëpunimit me institucione tjera dhe të ketë komunikim të duhur me gjyqtar, policinë, palët në procedurë etj.

Të nderuar anëtar të Komisionit:

Në fund të këtij koncept dokumenti, duhet të cekim faktin se duke marr për bazë punën tim në cilësi të Prokurorit të Shtetit, fillimisht përvojën time në Departamentin e Përgjithshëm, pastaj Departamentin për të Mitur dhe tani Departamentin për Krime të Rënda, bashkëpunimin tim të ngusht dhe ofrimin e mbështetjes profesionale për Prokurorët në tri departamentet, ku me përgjegjësi, intergjitet dhe profesionalizëm konsideroj që kam arrit të i kryej detyrat dhe përgjegjësit që më janë besuar, kam bindje që edhe më tutje do të kryej të gjitha punët dhe detyrat në pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjti do të publikohet në uebportal

Nënshkrimi:  _____

Datë: 08.11.2024